

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

STUDIMET POSTDIPLOMIKE - MASTER

DREJTIMI KONTRATAT DHE E DREJTA KOMERCIALE



PUNIM MASTERI

**Roli dhe rëndësia e Bankës Qendrore të Kosovës në raport me siguruesit-
aspekti juridik**

Mentor:

Prof.Dr. Rustem Qehaja

Kandidatja:

Lirie Dubova

Prishtinë, 2023

Abstrakt

Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës si institucion i pavarur ne vendin tonë ka rolë tejet të rëndësishëm ndaj siguruesve që operojn në tregun tonë. Roli i saj përcaktohet me ligjet që janë në fuqi të cilat i japin kompetenca të gjera në përcaktimin e kushteve të ndryshme që siguruesit duhet të i plotësojnë ose në të kundërtën nuk mund të ushtrojnë funksionin e tyre. Andaj permes këtij punimi kam dashur që më shumë të hulumtoj se nëpërmjet cila fazave apo rrugëtimit që duhet të kalon një operues që dëshiron të fitoj të drejtën apo të licencohet si një sigurues dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë. Duhet pasur parasysh se pas licencimit siguruesi nuk ka te drejta të pakufizuara dhe nuk mund të i tejkaloj kompetencat e tij, pasi që roli i BQK-së në këtë rast është që të bëjë mbikqyrjen e tij dhe në rast se sheh shkelje atëher ka të drejtën e plotë që të veproj mbrenda kompetencave të saja.

Gjatë punimit të këtij hulumtimi si pika reference kam pasur atë se cilat janë kushtet kryesore që siguruesit duhet ti plotësojnë për t'u licencuar sipas ligjeve në fuqi, ku rolë të drejtpërdrejtë ka këtu BQK-ja e cila i parasheh kushtet e tilla, pastaj në cilat raste siguruesit duhet të raportojn BQK-në, ku është shtjelluar mjaftë mire gjatë hulumtimit e cila do të prezantohet dhe si referenc tjetër kam pasur edhe mënyrat dhe rastet e likuiditetit te kompanive siguruese e cila poashtu do të shtjellohet më gjatë.

Do të marim edhe disa raste praktike në të cilat BQK-ja ka ndërmarrë veprime të ndryshme ndaj kompanive siguruese që operojnë në territorin e Republikës së Kosovës.

Fjalët kyqe: Banka Qendrore, sigurues, licencimi, masa ndëshkuese dhe likuiditeti.